



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo obrazovanja, nauke, tehnologije i inovacije
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS

**RAPORTI I KOMISIONIT PROFESIONAL-SHKENCOR
PËR ZBATIMIN E PROCEDURËS SË ZGJEDHJES SË BASHKËPUNËTORIT
SHKENCOR PËR STUDIME NDËRDISIPLINARE DHE SHKENCË KOGNITIVE NË
INSTITUTIN PEDAGOGJIK TË KOSOVËS**

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtarinë kërkimore-shkencore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2003), nenit 48 të Statutit të Institutit Pedagogjik të Kosovës në Prishtinë, Rregullores nr. 60/25 të datës 08.04.2025 për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve në Institutin Pedagogjik të Kosovës, Ligjit të Punës nr. 03/L-212, si dhe vendimit nr. 88/25 të datës 10.09.2025, Këshilli Shkencor i Institutit ka shpallur konkurs për zgjedhjen e një Hulumtuesi në fushën e Edukimit/Pedagogjisë së Përgjithshme në Institutin Pedagogjik të Kosovës, dhe dosja për këtë konkurs është shqyrtuar nga ky komision.

Komisioni, pasi ka shqyrtuar me kujdes dokumentacionin e kandidatëve të paraqitur në konkurs, i paraqet Këshillit Shkencor të Institutit Pedagogjik të Kosovës vlerësimin profesional-shkencor për kandidatët e paraqitur për pozitën e Hulumtuesit në fushën e Edukimit/Pedagogjisë së Përgjithshme.

VLERËSIMI PROFESIONAL DHE SHKENCOR

Komisioni, pasi e ka shqyrtuar me kujdes dokumentacionin e kandidatëve të paraqitur në konkurs, i paraqet Këshillit Shkencor të Institutit Pedagogjik të Kosovës vlerësimin profesional-shkencor.

Detyra e komisionit është të shqyrtojë dokumentacionin dhe të hartojë raportin profesional. Me hartimin e raportit përfundon puna dhe përgjegjësia e këtij komisioni. Komisioni për zbatimin e procedurës së zgjedhjes së Hulumtuesit në Fushën e Edukimit/Pedagogjisë, i emëruar në mbledhjen e Këshillit Shkencor të Institutit Pedagogjik të Kosovës, ka këtë përbërje:

- Dr.sc. Amantina Pervizaj Kelmendi, Bashkëpunëtore shkencore, IPK, kryetare;
- Dr.sc, Faton Krasniqi, Bashkëpunëtor shkencor, Instituti Albanologjik, anëtar, dhe
- PhDc. Mevlude Aliu Gashi, Hulumtuese e pavarur, IPK, anëtare.

Bazuar në dispozitat e Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore, Statutit të Institutit Pedagogjik, si dhe Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve në Institutin Pedagogjik të Kosovës, procedura vlerësuese për zgjedhje/rizgjedhje mbështetet në kriteret që dalin nga aktivitetet si në vijim:

- Të ketë të përfunduara studimet bachelor dhe ato master në drejtimin e Edukimit/Pedagogjisë së Përgjithshme;
- Të jetë jo më i vjetër se 27 vjet kur zgjedhet për herë të parë;
- Të ketë notën mesatare së paku tetë (8) në studimet bachelor dhe ato master;
- Të ketë njohuri profesionale të gjuhës angleze (me shkrim dhe të folur)
- Të ketë përvojë të dëshmuar për punën dhe aktivitetet shkencore nga fusha e kërkuar me konkurs;
- Të ketë përvojë të dëshmuar për punën profesionale nga fusha e kërkuar me konkurs;
- Përparësi do të kenë kandidatët me së paku një punim shkencor të botuar në një revistë relevante ndërkombëtare, si dhe përvojë në mësimdhënie në nivelin AMU/AML.

Sipas konkursit në fjalë kandidati i zgjedhur pritët të kryej këto detyra:

- Planifikon dhe realizon hulumtime shkencore në fushën e edukimit, pedagogjisë së përgjithshme dhe digjitalizimit në arsim.
- Përpunon dhe analizon të dhënave duke përdorur metoda cilësore dhe sasiore, si dhe programe statistikore (p.sh. SPSS).
- Harton raporteve shkencore, artikuj dhe botime për revista relevante kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Kontribon në shkrimin dhe menaxhimin e projekteve të IPK-së, përfshirë aplikimet për fonde në organizata vendore e ndërkombëtare.
- Bashkëpunon me departamente të tjera të institutit dhe me partnerë të jashtëm për projekte dhe hulumtime të përbashkëta.
- Promovon përdorimin e teknologjisë dhe digjitalizimit në arsim përmes projekteve dhe iniciativave të reja.
- Harton planin individual të punës kërkimore-shkencore dhe profesionale;
- Përgatit raport për punët e realizuara;
- Kryen punë të tjera që i delegon udhëheqësi i departamentit dhe Drejtori.

Duke u mbështetur në dokumentacionin dhe dosjen e dorëzuar nga kandidatet, komisioni vërteton se në konkursin e shpallur më datë 11.09.2025, në gazetën "Epoka e re", faqen zyrtare të Institutit Pedagogjik të Kosovës dhe SIMBNJ, për pozitën e Hulumtuesit në Fushën e Edukimit/Pedagogjisë, kanë konkurruar tri kandidate - Qendresa Lushtaku me numër protokolli 01/25 datë konkurrimi 16.09.2025; Ermira Kajtazi Krasniqi me numër protokolli 02/25, datë konkurrimi 25.09.2025; dhe Edona Vojvoda me numër protokolli 03/25, datë konkurrimi 08.10.2025.

Komisioni, pasi e verifikoi dokumentacionin e dorëzuar, ka konstatuar se të tri kandidatet i plotësojnë kushtet formale juridike për t'ju nënshtruar procedurave të përzgjedhjes për Hulumtues në Fushën e Edukimit/Pedagogjisë. Komisioni i ka shqyrtuar dosjet e kandidateve dhe në bazë të kriterëve të shpallura në konkurs, përgatitjen akademike, përvojën e punës, të arriturat profesionale shkencore, projektet për zhvillimin e punës profesionale-shkencore, i ka paraqitur të dhënat biografike dhe bibliografike si më poshtë:

Tabela 1. Shënime përmblledhëse për kandidatët e paraqitur për pozitën: Hulumtuesit në Fushën e Edukimit/Pedagogjisë në Institutin Pedagogjik të Kosovës

N r	Emri dhe mbiemri i kandidatit	Studimet Bachelor dhe Master në Edukim/Pedagogji	Mosha (≤ 27 vjet)	Nota mesatare ≥ 8.0	Njohuri profesionale të gjuhës angleze	Përvojë kërkimore-shkencore	Punim shkencor në revistë ndërkombëtare	Trajnime Profesionale	Përvojë profesionale dhe akademike në fushën përkatëse (përfshirë mësimdhënien në nivelin AMU/AML)	Përmbushja e përgjithshme e kriterëve
1	Qendresa Lushtaku	Bachelor I Gjuhë Shqipe Master I Shkencave Filologjike	27 vjeçare	BA – 9.78 MA - 9.67	Nuk ka dëshmi	Një Seminar dhe Një pjesëmarrje në Projekt Hulumtues	Adaptation of Albanian Language and Literature Content and Curriculum in Peja Resource Center I (Planning Content and Teaching Methods in Individual Education Plans (IEP) and their Impact on the Achievement of blind and Visually Impaired Students in the Field of Reading Literacy) Pakistan Journal of Life and Social Sciences	Pjesëmarrje në trajnimin për Fushën Gjuhët dhe Komunikimi në zbatimin e Kurrikulës së re	Mësimdhënës e e Gjuhës Shqipe – International School of Prishtina 01.10.2022 – 01.08.2025 Mësimdhënës e e Gjuhës Shqipe – The British School of Kosova 01.09.2023 – 30.06.2025	Jo

							Volume 22, 2024.(2):2878 -2889			
2	Ermira Kajtazi	Bachelor i Arsimit Fillorë Master I Edukimit – Udhëheqja në Arsim	29 Vjeçar e	BA – 8.34 MA- 8.91	Dëshmi për nivelin A2	1 Konferencë Ndërkombëtar e – Prezantim me Poster KICER 2025	The role of the leader in the adaptation of novice teachers in the teaching process in primary schools TIJER- International Research Journal ISSN:2349- 9249 March 2025 Volume 12 , Issue 3 www.tijer.org	Udhëheqja dhe planifikimistrategji k në Arsimin Parauniversitar (32 orë) – Maj 2021 Ngritja e kapaciteteve për vet-menaxhim të shëndetit – Prill, 2023 Gjithëpërfshirja dhe individualizimi I mësimit për nxënës me nevoja të veçanta (PIA) – (56 orë)- Nëntor 2019 Program Trajnimi për klasën përgaditore dhe arsimin fillor nëzbatimin e kurrikulës së re- 2019 Program trajnimi – Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie		

3	Edona Vojvoda	Bachelor I Programit Fillor Master në shkenca të Edukimit	25 Vjeçar e	BA – 9.91 MA – 9.95	Dëshmi për nivelin B1 dhe B2	Dy konferenca Ndërkombëtare –KICER 2024 “Përjetimet e mësimdhënësve fillestarë gjatë viteve të para të ushtrimit të profesionit të mësimdhënës Konferenca Ndërkombëtare –KICER 2025 Eksplorimi I kulturës së bashkëpunimit kolegjial të mësimdhënësve të nivelit parauniversitar Përmirësimi I praktikave reflektuese të mësimdhënësve përmes të mësuarit me bazë projektin.	Navigating the first years: Challenges and growth in early-career teaching <i>International Journal of Learning and Change-Submitted - In process</i> Learning opportunities for reading comprehension in Kosovar primary schools: to what extent can variance in reading comprehension be explained by instructional quality? <i>International Journal of Educational Reform IJER-25-0216-</i>	<u><i>Student I Këmbyer në kuadër të programit Erasmus +, në Universitetin e Gaz-it ,Austri. 04- 06 Shtator 2024 16-20 Shtator 2024</i></u> Kurset e ndjekura: SEL(Social emotional Learning)– (4 ECTS) Secrets of Academia – <i>Workshop-në Universitetin e GRAZ-it Nëntor 2024</i> OER QUICK START: Eine Einführung in dies Nutzunf Freirer Bildungsmateriale n – <i>Kurs në Universitetin e Graz-it Mars 2025</i> Resilience & wellbeing in academia”-	Mësimdhënëse klasore zëvendësim SHFMU “Mehmet Gjevori”-Prishtinë 21.05.2025	Po
---	---------------	--	-------------	----------------------------	------------------------------	---	---	---	---	----

<i>Journal of research in reading – JRR- Submitted- In process</i>

PËRFUNDIM

Në bazë të Ligjit për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, nr. 04/L-135, të datës 28.03.2013, si dhe Statutit të Institutit Pedagogjik të Kosovës, nr.01/B, nr.1740, të datës 11.06.2024, Rregullores nr. 55/24 për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve në Institutin Pedagogjik të Kosovës të datës 08.04.2024, në bazë të kriterëve dhe detyrave të përcaktuara me konkursin e shpallur me datë 11.09.2025 si dhe bazuar në të arriturat profesionale dhe shkencore, komisioni profesional-shkencor për zbatimin e procedurës së përzgjedhjes së Hulumtuesit në Fushën e Edukimit/Pedagogjisë në Institutin Pedagogjik të Kosovës, i propozon Këshillit Shkencor të Institutit Pedagogjik të Kosovës kandidaten **Edona Vojvoda**, e cila më së miri i plotëson kushtet e parapara në konkurs.

ARSYETIM

Kandidatja Edona Vojvoda ka përfunduar studimet Baçelor në Programin Fillor dhe Master në Shkenca të Edukimit, me sukses të lartë (BA – 9.91; MA – 9.95). Ajo është 25 vjeçare dhe posedon dëshmi për njohjen e gjuhës angleze (niveli B1 dhe B2). Ka marrë pjesë në dy konferenca ndërkombëtare KICER (2024 dhe 2025), me prezantime që trajtojnë zhvillimin profesional të mësimdhënësve dhe përmirësimin e praktikave reflektuese në mësimdhënie. Ka katër punime shkencore të dërguara për botim në revista ndërkombëtare të indeksuara (në proces shqyrtimi) dhe ka ndjekur programe trajnimi dhe shkëmbimi Erasmus+ në Universitetin e Graz-it (Austri), përfshirë kurse mbi mësimin socio-emocional, reziliencën akademike dhe vlerësimin në epokën e inteligjencës artificiale. Aktualisht, ushtron detyrën e mësimdhënëses në SHFMU “Mehmet Gjevari” – Prishtinë, duke dëshmuar përkushtim dhe profesionalizëm në fushën e arsimit. Në raport me kandidatet tjera, më së miri i plotëson kushtet dhe kriteret e kërkuara me konkurs, prandaj komisioni i propozon Këshillit Shkencor të Institutit Pedagogjik të Kosovës znj. Edona Vojvoda për pozitën e Hulumtuesit në Fushën e Edukimit/Pedagogjisë.

Prishtinë, më 27.10.2025

**Komisioni profesional-shkencor për zbatimin e procedurës
së zgjedhjes së Hulumtuesit në Fushën e Edukimit/Pedagogjisë në IPK**

1. Dr.sc.Amantina Pervizaj Kelmendi (Kryetare) _____
2. Dr.sc.Faton Krasniqi (Anëtar) _____
3. PhDc.Mevlode Aliu Gashi (Anëtare) _____